



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 13.02.2019

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 171/2014 "PËR PËRFUNDIMIN E
PROCEDURAVE LIGJORE TË KALIMIT TË TOKËS BUJQËSORE TË ISH-
NDËRMARRJEVE BUJQËSORE NË PRONËSI TË PËRFITUESVE", TË
NDRYSHUAR”

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “**“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 171/2014 "për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", të ndryshuar”**”, në mbledhjet e datave 24 tetor 2018 dhe 13 shkurt 2019.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin caktoi deputetin Besnik Baraj relator për shqyrtimin e këtij projektligji.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin propozuesi i nismës, deputeti Erion Braçe dhe përfaqësues të ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “**Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 171/2014 "për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", të ndryshuar”**”, është një nismë e deputetit Erion Braçe, e cila i paraqitet për shqyrtim Kuvendit, mbështetur në nenin 81 pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Qëllimi i këtij projektligji është rishikimi i disa dispozitave të ligjit aktual, të cilat kanë krijuar problematika në zbatimin e tij, dhe që janë të lidhura me çështjet e mëposhtme:

a. Shumë familje bujqësore apo pjesëtarë të këtyre familjeve, të cilët kanë përfituar tokë në përdorim sipas dispozitave të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi, nuk mund të pajisen me aktin e marrjes në pronësi të tokës për shkak të kufizimeve të vendosura në legjislacion për mos ndryshimin e vendbanimit.

b. Për shkak të vonesave për transferimin e dokumentacionit të gjendjes civile përtej afateve të përcaktuara në legjislacion, shumë familje bujqësore pavarësisht se kanë qenë banor “de facto” të njërive vendore të ish- ndërmarrjeve bujqësore nuk mund të pajisen me aktin e marrjes së tokës në pronësi.

c. Komisionet e tokës në fshat, në shume raste, nuk kanë plotësuar të plotë dhe të saktë dokumentacionin për përfitimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi (AMTP) për të gjitha familjet bujqësore, pavarësisht se këto familje i plotësonin kriteret ligjore për të qenë përfitues.

Për adresimin e këtyre problematikave projektligji propozon:

- i. Heqjen e kufizimit përsa i takon kriterëve që duhet të përmbushin familjet bujqësore ose individët për mos ndryshimin e vendbanimit të tyre prej datës 1.10.1992. Ky ndryshim do të shërbejë për zgjidhjen e problematikave të tilla si vonesat gjatë transferimit të dokumentacionit të gjendjes civile përtej afateve të përcaktuara në legjislacion.
- ii. Riformulimin e nënshkronjës iii), të pikës 1, të nenit 2, të ligjit duke krijuar mundësi për të gjithë familjet bujqësore të cilat disponojnë aktin e marrjes në përdorim për të përfituar aktin e marrjes së tokës në pronësi pavarësisht përcaktimeve përjashtuese të bëra në VKM nr. 452, datë 17.10.1992, "Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore", të ndryshuar. Familjet bujqësore që përdorin tokën do të përfitojnë aktin e marrjes në pronësi vetëm pasi të kenë vërtetuar se nuk kanë përfituar tokë bujqësore në përdorim apo në pronësi në qendrat e tyre të mëparshme të banimit.
- iii. Shtimin e dy pikave të tjera të cilat propozojnë, që të jenë subjekt i ligjit: familjet bujqësore, të cilat nuk e disponojnë aktin e marrjes në përdorim të tokës vetëm pasi të kenë vërtetuar se nuk kanë përfituar tokë bujqësore në përdorim apo në pronësi në qendrat e tyre të mëparshme të banimit si dhe familjet bujqësore të cilat e disponojnë aktin e marrjes së tokës në përdorim, por këtë akt e kanë përfituar pas datës 31.12.1993, për këto të fundit toka do të mbetet në përdorim.
- iv. Zgjatjen e afatit të përfundimit të procesit të plotësimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, për territoret e ish-ndërmarrjeve bujqësore deri më 30 qershor 2019.

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektligji janë bashkitë, këshillat e qarqeve, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, drejtoritë e bujqësisë, Komisioni Qeveritar i Tokës dhe Komisionet Vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe prefektët e çdo qarku.

- ***Diskutimi në komision***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese Tregtinë dhe Mjedisin e shqyrtoi këtë projektligj, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 24 tetor 2018 dhe 13 shkurt 2019.

I pranishëm në mbledhjen e Komisionit, për të shpjeguar nismën dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, ishte propozuesi i saj, deputeti Erion Braçe dhe përfaqësues të ministrisë së Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural.

Në fjalën e tij Z. Braçe theksoi se nismat e propozuara prej tij kanë të bëjnë drejtpërdrejt me probleme konkrete që lidhen me çështjen e pronësisë së tokës bujqësore, me proceset e zhvilluara në raport me të dhe përmbushin interesa jo vetëm të banorëve të atyre zonave, por edhe të deputetëve që mbulojnë në Kuvendin e Shqipërisë zona përgjithësisht rurale, të cilat kanë probleme të këtij lloji çdo ditë.

Ndryshimet e propozuara në projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 171/2014 “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, të ndryshuar synojnë të adresojnë tre tipologji familjesh bujqësore:

- E para, ka të bëjë me çështjen e vendosjes në ato territoret rurale dhe bujqësore të familjeve bujqësore të vendosur fizikisht në atë territor përpara datës 1 gusht 1991, por që nuk kanë dokumentet e pasaportizimit në këtë territor.

Ligji ka vendosur datën 1 gusht të vitit 1991 si kufi për të përfutur tokë dhe që ta përfutoje këtë tokë në pronësi, përfutuesi duhet të provonte që pasaportizimi i tij në këtë territor ka ndodhur para datës 1 gusht 1991.

Por, aktualisht rezulton që familjet bujqësore të jenë vendosur fizikisht para datës 1 gusht i vitit 1991, por për shkak të situatës që ishte në atë periudhë, veçanërisht në institucione, dhe përgjegjësinë e tyre për t'i dhënë zgjidhje edhe këtij problemi, pra pasaportizimit të këtyre familjeve në këto territore, ka ndodhur që pasaportizimi të ketë ndodhur pas datës 1 gusht të vitit 1991. Për këtë arsye këto familje janë pajisur me tokë nga komisionet e ndarjes së tokave në atë periudhë, kanë marrë tokën sipas normës për frymë, që ishte vendosur në legjislacionin në fjalë, por toka e tyre ka mbetur në përdorim, sepse ligji ndalon apo kufizon marrjen e tokës në pronësi për këto familje, të cilat kanë provuar që pasaportizimi i tyre ka ndodhur pas datës 1 gusht të vitit 1991.

Ndryshimi që propozon projektligji qëndron në faktin se, veç zhvendosjes së kësaj date secila prej këtyre familjeve, duhet të provojë dy gjëra: së pari, që është vendosur faktikisht në këtë territor para datës 1 gusht të vitit 1991 dhe që ka mundësi që ta provoj, për shembull, regjistrimi i fëmijëve në shkollë para kësaj date në këto territore është një element i rëndësishëm për ta paraqitur si provë; së dyti, të provojnë që në zonën, ku kanë banuar më herët dhe nga e cila kanë ardhur dhe janë vendosur këtu para datës 1 gusht të vitit 1991 nuk kanë marrë apo nuk kanë përfutur tokë qoftë me ligjin nr. 7501 qoftë me ligje të tjerë. Kjo është një tipologji që është më masivja, sidomos në zonën e Myzeqesë.

- Tipologjia e dytë është ajo e familjeve bujqësore apo edhe individëve, të cilët në periudhën apo në momentin kur ka ndodhur procesi i regjistrimit të tokës pas ndarjes për efekt të certifikimit të saj e certifikatë pronësie nuk kanë qenë në këtë territor, por kanë qenë në emigracion, nuk kanë qenë pjesë e këtij procesi, mund të jenë zhvendosur brenda territorit të vendit për një apo për disa arsye, por vendbanimin e përhershëm, natyrisht edhe pasaportizimin e ka pasur në këto territore, apo janë harruar fare në procesin e regjistrimit të kësaj toke. Domethënë, me ligjin që është sot në fuqi, për shkak se ka ndryshuar vendbanimi në kohë të caktuara, këtyre familjeve pavarësisht se e shfrytëzojnë atë tokë nuk u jepet e drejta e ndjekjes së procedurës të marrjes së tokës në pronësi.
- Tipologjia e tretë është ajo e familjeve bujqësore apo edhe individëve, të cilët në periudhën apo në momentin kur ka ndodhur procesi i regjistrimit të tokës pas ndarjes për efekt të certifikimit të saj e certifikatë pronësie nuk kanë qenë në këtë territor, por kanë qenë në emigracion, nuk kanë qenë pjesë e këtij procesi, mund të jenë zhvendosur brenda territorit të vendit për një apo për disa arsye, por vendbanimin e përhershëm, natyrisht edhe pasaportizimin e ka pasur në këto territore, apo janë harruar fare në procesin e regjistrimit të kësaj toke. Domethënë, me ligjin që është sot në fuqi, për shkak se ka ndryshuar vendbanimi në kohë të caktuara, këtyre familjeve pavarësisht se e shfrytëzojnë atë tokë nuk u jepet e drejta e ndjekjes së procedurës të marrjes së tokës në pronësi. Pra, janë familje, të cilat janë zhvendosur me vendime të Këshillit të Ministrave nga pjesë të ndryshme të territorit të vendit në brendësi të territorit vendosur në këto zona, pra në tokat që janë administruar nga ndërmarrjet bujqësore. Toka për ta është ndarë përsëri me atë normë të përcaktuar me vendimet e Këshillit të Ministrave për frymë. Pavarësisht se u është dhënë mundësia që ta kalojnë tokën në pronësi, për shkak të një afati që është vendosur në ligj dhe që skadon në 31.12.2018, të gjitha këto familje mund të humbin të drejtën e marrjes së tokës në pronësi.

Relatori vlerësoi ndërmarrjen e kësaj nisme ligjore, si nevojë për adresimin e problematikave të evidentuara për sa i takon pajisjes me aktin e marrjes në pronësi të tokës për shumë familje bujqësore apo pjesëtarë të këtyre familjeve, të cilët kanë përfituar tokë në përdorim sipas dispozitave të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi por për shkak të kufizimeve të vendosura në legjislacion për mos ndryshimin e vendbanimit nuk mund përfitojnë nga e drejta e kalimit në pronësi të tokës bujqësore dhe për të siguruar vijimësinë e procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve dhe përfundimin sa më shpejtë të këtij procesi.

Përfaqësuesit e ministrisë shprehën mbështetjen e tyre për ndryshimet që propozon z. Braçe dhe sqaruan se projektligji synon të adresojë dy çështje kryesore: zgjatjen e afatit për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore në pronësi të përfituesve edhe për periudhën nga data 1 Janar 2019 deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me qëllim për të siguruar vijimësinë dhe zbatimin e parashikimeve të këtij ligji; dhe nxjerrjen e një kategorie të re përfituesish, të atyre banorëve të zonave rurale që e përdorin tokën për qëllime bujqësore.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit nën për nën deputetët u njohën edhe me propozimet e Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, e cili e shqyrtoi projektligjin në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi.

Këto propozime synojnë:

1. Të adresojnë problematikën e parashtruar në relacionin shoqërues të nismës, me qëllim reflektimin e gjendjes së shumë familjeve të cilat për shkak të mosveprimit në kohë nga institucionet e pushtetit vendor iu është transferuar gjendja civile, pas dt 1.8.1991;

Për këtë qëllim propozohet:

- a. Pika 1 të ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Nënparagrafi “ii” i shkronjës “a” të pikës 1 shfuqizohet” dhe pas pikës 1 të shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

“1/1. Pas shkronjës b) të pikës 1, shtohet shkronja c) me përmbajtjen si më poshtë:

c) Familjet bujqësore ose individët, të cilët përmbushin kushtet si më poshtë:

- i) *janë punonjës të ish-ndërmarrjes bujqësore më 1.8.1991, gjendja civile e të cilëve u është transferuar në fshatin ku gjendet toka objekt i kalimit në pronësi, pas datës 1.8.1991, por të mos kenë përfituar tokë bujqësore në përdorim apo pronësi, në fshatin ku kanë patur gjendjen civile më 1.8.1991.*
- ii) *e përdorin tokën për veprimtari bujqësore por kanë mungesa në plotësimin e dokumentacionit të përdorimit apo pronësisë.*

“1/2 Pas shkronjës c) të pikës 1, shtohet shkronja d) me përmbajtjen si më poshtë:

d) Familjet bujqësore ose individët, të cilët përmbushin kushtet si më poshtë:

- i) *nuk kanë qenë punonjës të ish ndërmarrjeve bujqësore, por kanë qenë banorë të fshatit ku gjendet toka bujqësore, objekt i kalimit të pronësisë, sipas regjistrit të gjendjes civile më 1.8.1991, por të mos kenë përfituar më parë tokë bujqësore në përdorim apo pronësi;*
- ii) *e përdorin tokën për veprimtari bujqësore por kanë mungesa në plotësimin e dokumentacionit të përdorimit apo pronësisë.*

- b. Pikat 2 dhe 3 të shkronjës “a” të pikës 1, të hiqen, pasi problematika e pasqyruar në relacionin shpjegues e cila ka shërbyer si shkak për ndërmarrjen e kësaj nisme ligjore adresohet nëpërmjet propozimit të paraqitur më sipër.

2. Të shtyjnë afatin e përfundimit të kalimit të tokës bujqësore në pronësi të përfituesve deri në datën 31 Dhjetor 2019;

Për këtë qëllim propozohet që në nenin 6, pika 1 të ndryshohet me këtë përmbajtje:

“1. Afati për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve mbyllet në datën 31 Dhjetor 2019.”

3. Të konsiderojnë të vlefshme praktikën në proces dhe të papërfunduara deri në datën 1 Janar 2019 si dhe aplikimet paraqitura deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, për të siguruar vijimësinë dhe zbatimin e parashikimeve të këtij ligji edhe për periudhën nga data 1 Janar 2019 deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duke qenë se afati për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore në pronësi të përfituesve sipas parashikimeve të ligjit aktual 171/2014 është mbyllur në datën 31.12.2018.

Për këtë qëllim propozohet të shtohet një nen i ri me këtë përmbajtje:

“Neni 2/1

Dispozitë kalimtare

Praktikat në proces dhe të papërfunduara deri në datën 1 Janar 2019 si dhe aplikimet paraqitura deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji konsiderohen të vlefshme.”

- ***Ndryshime të projektaktit***

Në përfundim të shqyrtimit nën për nen, Komisioni u shpreh dakord me propozimet e Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të drejtat e Njeriut, dhe me qëllim integrimin sa më të plotë të tyre, duke mbajtur në konsideratë dhe parimet e teknikës legislative, miratoi variantin integral të projektligjit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij Raporti.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni, me shumicë votash, miratoi variantin integral të projektligjit në parim, nën për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

RELATOR

KRYETAR

Besnik BARAJ

Niko PELESHI